

Analizë e shkurtër  
**(Pa)drejtësia në Urbanizmin e Prizrenit?**  
Mars 2015, Prizren

## PËRMBAJTJE

I. Hyrje .....	2
II. Sfondi .....	2
III Çka do të thotë sundimi i ligjit.....	3
IV. Të gjeturat dhe konkluzionet e monitorimit.....	3
V. Përfundim .....	7
VI. Rekomandime .....	8
VII. Për projektin .....	8
EC Ma Ndryshe .....	9

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.*

**SOROS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

## I. Hyrje

Thirrjet e publikut për mbrojtjen e Qendrës Historike të Prizrenit nuk po merren parasysh nga institucionet e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, si në nivelin lokal ashtu edhe atë qendror. Këto institucione, që kanë detyrime të qarta ligjore për të vepruar për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore e historike në këtë Qendër prej vitesh kanë vendosur që t'i mbyllin sytë dhe veshët kundruall degradimit urbanistik në këtë zonë të veçantë të qytetit të Prizrenit, duke instaluar në mënyrë të heshtur kulturën e pandëshkueshmërisë. Ky konstatim i EC Ma Ndryshe, i dokumentuar me raste konkrete përgjatë më shumë se dy vitesh<sup>1</sup> tashmë konfirmohet edhe nga të dhënat statistikore të marra nga institucionet përgjegjëse. Këto të dhëna në të shumtën e rasteve pos që nuk janë të strukturuar, në aspektin e shtrirjes kohore kanë mungesa të theksuara, derisa vija ndarëse vetëm për rastet në Qendrën Historike të Prizrenit pothuajse nuk ekziston për gjyqësorin. Mirëpo, këto të dhëna mjaftojnë për të përshkruar edhe njëherë me shifra dështimin e institucioneve në zbatimin e legjislacionit që janë hartuar dhe miratuar me qëllim të ruajtjes së vlerave historike të kësaj Qendre.

## II. Sfondi

EC Ma Ndryshe në Analizën "Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike" (prill, 2014)<sup>2</sup> ka argumentuar se shteti i Kosovës në përgjithësi dhe Qendra Historike e Prizrenit kanë kornizë legjislative dhe institucionale shumë të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë

kulturore. Një numër ligjesh, aktesh nënligjore, dokumentesh strategjike të nivelit qendror, por edhe planesh lokale janë në fuqi tashmë një kohë të gjatë. Realizimi i obligimeve ligjore që dalin nga këto dokumente është përgjegjësi e një numri të madh institucionesh qendrore dhe lokale, përfshi ministritë e linjës, komunat, gjyqësorin dhe policinë. Këto përgjegjësi janë të definuara në mënyrë shumë të qartë dhe nuk lënë aspak hapësirë për interpretime ose keqkuptime. Me gjithë këtë kornizë legjislative dhe institucionale mjaft të avansuar, Qendra Historike e Prizrenit vazhdon të degradohet në mënyrë sistematike.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për vitin 2014<sup>3</sup> ka konstatuar dështimin e aparatit shtetëror në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, me theks edhe në Prizren. Madje aty kërkohet zbatimi i masave ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjit. "Në përgjithësi, shkeljet e shpeshta të ligjit në tërë Kosovën kanë vazhduar që të kenë ndikim negativ në objektet e trashëgimisë fetare dhe kulturore. Zbatimi i kornizës së përgjithshme ligjore që rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore mbetet i dobët. Ndërtimet pa leje janë një shqetësim i madh, sidomos në Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Masat ndëshkuese ndaj atyre që shkelin ligjin duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërtimet pa leje që tashmë kanë ndodhur duhet të trajtohen në përputhje me ligjin. Autoritetet e Kosovës, sidomos ato të nivelit lokal, duhet të demonstrojnë një përkushtim më të madh në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore", thuhet në Raport. Hartuesit e raportit kanë vënë në pah faktin se komuna e Prizrenit nuk ka ofruar mbështetjeje

<sup>1</sup> Harta e parregullive urbanistike, qasja në vegëzën: <http://www.online-transparency.org/harta/>

<sup>2</sup> Analiza, qasja në vegëzën: [http://online-transparency.org/repository/docs/Ligjet\\_nuk\\_po\\_e\\_mbrojne\\_QH.pdf](http://online-transparency.org/repository/docs/Ligjet_nuk_po_e_mbrojne_QH.pdf)

<sup>3</sup> Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, qasja në vegëzën: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore, mekanizëm ky që ka buruar nga Ligji për Qendrën Historike të qytetit. "Zbatimi i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është frenuar nga mungesa e mbështetjes nga komuna. Takimet e KTK-së janë mbajtur dhe janë dhënë një numër vendimesh në lidhje me lejet ndërtimore. Sidoqoftë, komuna duhet t'i ofrojë Këshillit kompensimin e duhur, pajisje dhe personal, në mënyrë që ai të funksionoj siç parashihet me ligj", thuhet në Raport, ku po ashtu është përmendur krijimi i Task Forcës për ndërtimet pa leje si zhvillim inkurajues, që megjithatë duhet të dëshmojë efektivitetin e vet.

### III. Çka do të thotë Sundimi i ligjit?

Një formulim i thjeshtë i idesë së "sundimit të ligjit" është ideja që shoqëria duhet të sundohet nga "ligji, dhe jo njerëzit". Në nivelin ndoshta më thelbësor, "sundimi i ligjit" si i tillë nënkupton një sistem në të cilin qeverisja është e bazuar në rregulla të paanshme dhe universale. Ky formulim bazik e vë theksin mbi tri koncepte të ndërthurura: 1) që të drejtat ligjore duhet të imponohen vetëm nga ligji, jo mbi bazën e vullnetit personal apo vendimeve arbitrare të zyrtarëve të qeverisë apo akterëve privatë (paanshmëria), 2) se veprimet e Qeverisë duhet të jenë të rregulluara me rregullore dhe se zyrtarët e qeverisë nuk duhet të jenë mbi ligjin (universalja) dhe 3) se njerëzit duhet të mbrohen nga dhuna dhe forca private (qeverisja). Një parakusht i përgjithshëm për sundimin e ligjit është një gjyqësor i fuqishëm, i pavarur dhe i qasshëm, që do të kërkoj llogari nga qeveritarët dhe që do të vendos rend e rregull në rastet e shkeljeve të ligjit<sup>4</sup>. Në rastin e

Prizrenit, respektivisht Qendrës Historike, sikur rolet janë ndërruar dhe në vend të ligjit sundimi i takon njerëzve "të fuqishëm", derisa zyrtarët e qeverisë lokale mbi bazën e vullnetit personal duke treguar se janë mbi ligjin realizojnë projekte të ndryshme infrastrukture pa i përfillur procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin përkatës, ndërkohë që nuk ka mbrojtje për pjesëtarët e thjeshtë të komunitetit e as për hapësirat publike.

### IV. Të gjeturat dhe konkluzionet e monitorimit

Gjatë muajit tetor, nëntor dhe dhjetor, monitoruesit e "EC Ma Ndryshe" kanë bërë përpjekje që në përputhje me dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike të sigurojnë të dhëna të detajuara nga institucionet përgjegjëse mbi nivelin e degradimit në Qendrën Historike të Prizrenit. Në këtë drejtim janë kërkuar informata mbi numrin e lëndëve që ka në shqyrtim Gjykata Themelore e Prizrenit, numrin e rasteve të raportuara në Polici dhe numrin e rasteve të nisura/trajtuara nga Policia, numrin e rasteve që ka pranuar Prokuroria dhe numrin e hetimeve të nisura, numrin e raporteve që ka përgatitur Inspektorati i Komunës së Prizrenit si dhe numrin e rasteve që i ka dërguar në Gjykatë, numrin e ndërtimeve pa leje dhe sipërfaqen në metra katrorë, numrin e monumenteve të mbrojtura dhe numrin e monumenteve të humbura. Këto të dhëna në të shumtën e rasteve pos që nuk janë të strukturuar, në aspektin e shtrirjes kohore kanë mungesa të theksuara, derisa vija ndarëse vetëm për rastet në Qendrën Historike të Prizrenit pothuajse nuk ekziston për gjyqësorin. Në të njëjtën kohë transparenca në ofrimin e qasjes në dokumente publike, është e kufizuar vetëm në ofrimin e përgjigjeve gojore apo me shkrim, pa kopje të dokumenteve përcjellëse të kërkuara.

<sup>4</sup> "History and Importance of the Rule of Law", 2003, Theo J. Angelis, and Jonathan H. Harrison. [http://worldjusticeproject.org/sites/default/files/history\\_and\\_importance\\_of\\_the\\_rule\\_of\\_law.pdf](http://worldjusticeproject.org/sites/default/files/history_and_importance_of_the_rule_of_law.pdf)

### a) Numri i lëndëve që ka në shqyrtim Gjykata Themelore e Prizrenit

Gjykata Themelore e Prizrenit ka bërë të ditur se nuk ka asnjë lëndë në shqyrtim sa i përket dëmtimit të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit<sup>5</sup>. Divizioni i Kundërvajtjes së kësaj Gjykate ka pranuar në shqyrtim lëndë që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje, mirëpo zyrtarët e Gjykatës asnjëherë nuk kanë ofruar të dhëna se sa lëndë kanë të bëjnë specifikisht me dyshimet për shkeljet urbanistike në Qendrën Historike të Prizrenit.

#### *Konkluzion:*

Gjykata është treguar totalisht mospërfillëse për rastet e shkeljeve ligjore në Qendrën Historike të Prizrenit, që sipas legjislacionit të Kosovës mund të përmbajnë edhe elemente të veprës penale, ndërkohë që kundërvajtjet vetvetiu nënkuptohen.

### b) Numri i rasteve të raportuara në Polici dhe numrin e rasteve të nisura/trajtura nga Policia

Lidhur me numrin e rasteve të raportuara në Polici dhe numrin e rasteve të nisura/trajtura nga Policia për ndërtimet pa leje, tejkalime të lejeve, rrënim e dëmtim të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit, Policia rajonale e Prizrenit ka theksuar se nuk i posedon këto statistika<sup>6</sup> dhe se ato mund të kërkohen në Komunën e Prizrenit.

#### *Konkluzion:*

Bazuar në raportet mediale, në vitet e kaluara janë disa raste në të cilat ka pas ankesa për

<sup>5</sup> Komunikim me E-mail, Gjykata Themelore e Prizrenit, datë 22.10.2014

<sup>6</sup> Komunikim me E-mail, Policia rajonale e Prizrenit, datë 22.10.2014

dëmtimin e objekteve të trashëgimisë vernakulare, fetare e kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit, me ç'rast Policia e Kosovës së paku është dashur që të nisë hetimet, sikurse në rastin e shtëpisë së familjes Shehu, Kishës së Shën Dielës, Shën Premtes, Xhamisë së Sejdi Beut, etj.

### c) Numri i rasteve që ka pranuar Prokuroria dhe numri i hetimeve të nisura

Raporti statistikor i Prokurorisë Themelore për ndërtimet pa leje, tejkalime të lejeve, rrënim e dëmtim të monumenteve në Qendrën Historike të Prizrenit<sup>7</sup>, vë në pah numrin e vogël të aktakuzave të ngritura dhe numrin edhe më të vogël të aktgjykimeve dënuese. Sipas të dhënave të Prokurorisë del se në vitin 2014 janë bërë 7 kallëzime penale, ku 2 raste janë në hetime, 1 rast është hedhur, derisa në 2 raste janë pushuar hetimet. Në vitin 2013, janë bërë 7 kallëzime, 2 raste janë në hetime, 1 rast është hedhur poshtë, derisa në 2 raste janë pushuar hetimet. Në këtë vit janë ngrehur 2 aktakuza dhe vetëm një ka përfunduar me aktgjykim dënues. Në vitin 2012, janë bërë 2 kallëzime penale dhe në 3 raste janë pushuar hetimet. Ndërsa në vitin 2011 janë ngrehur 2 aktakuza dhe në 2 raste aktgjykimet kanë qenë refuzuese. E në vitin 2007 ka pasë 1 aktakuzë dhe 1 aktgjykim dënues.

#### *Konkluzion:*

Pra, përgjatë 7 viteve të fundit sipas të dhënave të ofruara nga Prokuroria vetëm dy raste kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, 2 refuzuese, derisa 4 raste mbeten në hetime, ndërkohë që në 7 raste janë pushuar hetimet<sup>8</sup>.

<sup>7</sup> Komunikim me E-mail Prokuroria Themelore e Prizrenit, datë 28.10.2014

<sup>8</sup> Komunikim me E-mail Prokuroria Themelore e Prizrenit, datë 28.10.2014

Këto të dhëna janë dëshmi konkrete për kulturën e pandëshkueshmërisë, e cila tashmë ka lëshuar rrënjë në shoqërinë tonë.

#### **d) Numri i raporteve që i ka përgatit Inspektorati i Komunës dhe i rasteve që i ka dërguar në Gjykatë**

Drejtoria e Inspektorateve të Komunës së Prizrenit në kërkesën e bërë nga EC Ma Ndryshe është përgjigjur fillimisht me shkresën e datës 29.10.2014<sup>9</sup>, ku ka theksuar se ofron raport kronologjik për ndërtimin e objekteve në Qendrën Historike, duke filluar prej muajit mars deri më 25 tetor 2014.

Sipas kësaj informate të DI-së në 17 lokacione janë duke u zhvilluar ndërtimet, kryesisht me leje për ndërtim, me përjashtim të një lokali në renovim ku punimet janë ndërprerë deri në pajisjen me leje, ndërkohë që në dy raste investitorët janë në fazën përfundimtare për tu pajisur me leje, dhe vetëm në një rast ka pasë mbindërtim pa leje është iniciuar procedura në gjyq.

Ndërsa në përgjigjen me shkrim të datës 18.11.2014<sup>10</sup>, thuhet se deri më 31 tetor 2014 Inspektorati i ndërtimtarisë ka përpiluar 17 procesverbale, ka lëshuar 4 aktvendime dhe një rast e ka proceduar në Gjykatën Kompetente.

Për të dhëna më të detajizuara kanë udhëzuar që të kërkohen nga Task Forca e krijuar për QHP-në nga MMPH-ja.

#### *Konkluzion:*

Përgjigjet e DI-së, sipas monitoruesve të EC Ma Ndryshe, kanë mangësi substanciale si në

përmbajtje ashtu edhe në shtrirjen kohore. Në këtë pikëpamje DI-ja është treguar jo-transparente disa herë pasi që ka vite që EC Ma Ndryshe kërkon nga DI-ja listën e objekteve për rrënim, por nuk ka marrë asnjë përgjigje konkrete, sikurse edhe në rastin e raporteve të përgatitura dhe lëndët e dërguara në Gjykatë. Madje hedhja e përgjegjësisë në një institucion tjetër, duke refuzuar marrjen e përgjegjësisë, sikurse edhe llogaridhënien e transparencën e bën edhe më bajate qasjen e DI-së, ndaj problemit që tashmë ka gjetur vend edhe në raportet ndërkombëtare për Kosovën.

#### **e) Numri i ndërtimeve pa leje dhe sipërfaqja në metra katrorë**

Për shkak të përgjigjeve jo përmbajtjesore të DI-së, EC Ma Ndryshe ka kërkuar sqarime edhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, e cila që prej fillimit të vitit 2014 kishte proklamuar në media skanimin e gjendjes së Qendrës Historike të Prizrenit.

Në përgjigjen e marrë nga DUPH-ja më 3.11.2014<sup>11</sup> thuhet se ky organ nuk posedon të dhënat për ndërtimet pa leje dhe sugjeron që kjo kërkesë t'i adresohet DI-së.

#### *Konkluzion:*

Ngjashëm sikurse DI-ja edhe Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor është treguar mospërfillëse në ofrimin e të dhënave zyrtare për ndërtimet pa leje dhe sipërfaqet e tyre në metra katrorë, ngase DI dhe DUPH, përfaqësojnë bashkërisht pushtetin lokal dhe veprimet e tyre në çdo stad duhet të jenë të koordinuara dhe të pandara.

<sup>9</sup> Shkresa e DI-së, Nr. 17-354-150717/1, 29 tetor 2014

<sup>10</sup> Shkresa e DI-së, Nr. 17-354-163292/1, 18 nëntor 2014

<sup>11</sup> Shkresa e DUPH-së, Nr. 04-031-150414, 3 nëntor 2014

**f) Kërkesat për intervenim të QRTK-së**

QRTK më 3 janar 2014 i ka adresuar DI-së kërkesën për intervenim urgjent në rrugën "Sahat Kulla", pastaj "Vatrat Shqiptare", "Adem Jashari" dhe afër teqes Halveti, për shkak se investitorët kanë nisur punimet pa pëlqimin e QRTK-së, apo për shkak se nuk i janë përmbajtur pëlqimit të dhënë.

Më 27 janar 2014 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesë për ndalimin e punimeve pa leje në Shatërvan tek një restorant.

Më 29 janar 2014 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për verifikimin e zbatimit të projektit të renovimit të objektit të një ish-banke.

Më 20 mars 2014 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për intervenim në ndalimin e punimeve pa leje në rrugën Marin Barleti, ku theksohet se ndërtimi degradon pamjen e lagjes dhe zonën e mbrojtur.

QRTK më 23 qershor 2014 i dërgon DI-së njoftimin se në zonën historike të Prizrenit është bërë rrënimi i një objekti pa pëlqimin e QRTK-së.

QRTK më 8 shtator 2014 i shkruan DI-së për vendosjen e skeleve në një objekt në rrugën e Saraçëve pa pëlqimin e QRTK-së.

Më 13 tetor 2014 QRTK i dërgon DI-së një kërkesë për intervenim në parandalimin e punimeve pa leje në rrugën Marin Barleti, Rezmi Ademaj dhe Iljaz Kuka. Në shkresë po ashtu kërkohet marrja e masave kundër vendosjes së tendave në Sheshin Shadërvan, panove në monumente, etj, sikurse edhe për qarkullimin e kamionëve të rëndë mbi 3.5 tonë.

Më 22 mars 2013 QRTK i ka dërguar një shkresë DI-së ku kërkohet kontrollimi i gjendjes

ekzistuese lidhur me rrezikimin e një objekti nga punimet në fqinjësi brenda QHP-së.

Më 12 janar 2012 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për ndërprerjen e punimeve për vendosjen e kamerave në Xhaminë e Sinan Pashës pa pëlqimin e QRTK-së.

Më 4 korrik 2012 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për intervenim në rrugën Adem Jashari, ku investitori ka tejkaluar lejen urbanistike.

Më 5 shtator 2012 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për intervenim në rrugën Shuaip Spahiu, ku investitori ka tejkaluar lejen urbanistike.

Më 22 tetor 2012 QRTK i ka dërguar DI-së kërkesën për intervenim në rrugën e Pushkatarëve për shkak se objekti ekzistues është rrënuar dhe pa pëlqimin e QRTK-së ka nisur ndërtimi i objektit të ri.

***Konkluzion:***

Se a janë ndërmarrë veprime konform këtyre kërkesave nga DI nuk dihet, për shkak të mungesës së transparencës nga ana e organit komunal. Vlen të përmendet se ka edhe shumë raste të tjera ku monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë konstatuar shkelje të rregullave urbanistike ndërkohë që kanë munguar veprimet e DI-së dhe gjyqësorit. Madje EC Ma Ndryshe ka dokumentuar edhe shkeljet që janë bërë nga vet komuna brenda hapësirës së QHP-së gjatë realizimit të projekteve infrastrukturore. Të gjitha shkeljet janë pasqyruar në ueb faqen <http://online-transparency.org>, respektivisht në rubrikën: <http://www.online-transparency.org/harta/>.

### g) Numri i monumenteve të mbrojtura dhe të humbura (zhdukura) në QHP

Në bazë të dhënave të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren<sup>12</sup> brenda qendrës historike të Prizrenit gjenden 70 monumente të sistemuara në kategoritë: trashëgimi arkeologjike 10 asete, trashëgimi arkitekturore 59 asete dhe fushë e konservimit arkitekturor 1 aset.

Pas vizitave në terren nga ekipi i QRTK-së në verë të 2014-s del se nga monumentet e përfshira në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme të vitit 2013 brenda QHP-së 1 prej tyre nuk ekziston më, derisa 3 monumente janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje emergjente me karakter shpëtimi.

Sipas QRTK-së Shtëpia në rrugën e Pushkatarëve e shekullit XIX nuk ekziston më, derisa objektet e dëmtuara janë Kisha e Shën Nikollës (mesjetë), Ndërtesa e Shkollës së Mesme Ryzhdie (shek. XIX) dhe Shtëpia e familjes Agallari (shek. XIX).

Ndërsa shtojca 2 e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit<sup>13</sup> thekson se në total 104 objekte dhe 4 komplekse arkitekturore janë në mbrojtje. Po ashtu në kuadër të zonës së vjetër janë edhe komplekse të mbrojtura me ligj dhe që kanë vendim (para luftime). Ato janë: Kompleksi Marash, Nënkalaja, Pantelia dhe Potokmahalla. Në kuadër të këtyre komplekseve përfshihen të gjitha objektet brenda saj dhe ato kanë automatikisht vendimin nën mbrojtje. Edhe objektet e rralla ose objekte me vlerë të veçantë marrin statusin e objektit nën mbrojtje

si p.sh. trupat ndriçuese nga shekulli XX, punëtori të vjetra, kinema, etj. Andaj nuk mund të rumbullakohen me numra objekte me vlerë dhe se ato që nuk janë në listë nuk kanë vlerë. Nuk duhet harruar se procesi i vlerësimit është në vazhdimësi dhe nuk është përfunduar.

#### *Konkluzion:*

Institucionet relevante nuk kanë ofruar ndonjë të dhënë në lidhje me gjendjen e monumenteve që janë nën mbrojtje në saje të shtojcës 2 të Ligjit për QHP-në, që është një dëshmi tjetër se ato nuk e kanë marrë me seriozitet mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

### V. Përfundim

Ashtu sikurse edhe në analizën paraprake EC Ma Ndryshe konsideron se dëmtimi ose shkatërrimi i trashëgimisë kulturore përbën veprën penale dhe mosndëshkimi nënkupton paaftësinë e institucioneve për të siguruar sundim të ligjit. EC Ma Ndryshe beson se vetëm opsioni i ndëshkimit (me gjobë ose burgim) për veprën penale “dëmtim i trashëgimisë kulturore” mund të shpëtojë Qendrën Historike nga shkatërrimi sistematik. Kodi Penal i Kosovës, Ligji për Trashëgimi Kulturor dhe Ligji për kundërvajtje parashohin dispozita të qarta ndëshkuese, të cilat duhet të zbatohen në përpikëri nga organet përkatëse. Koordinimi në mes të institucioneve të shtetit, pra pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor është esencial për të vendosur rend urbanistik në këtë zonë, derisa organizimi qytetar mund të shtojë presionin tek institucionet për transparencë dhe llogaridhënie në raport me QHP-në.

<sup>12</sup> Shkresa QRTK-Prizren, 26 nëntor 2014

<sup>13</sup> Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836>

## VI. Rekomandime

- Zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes aplikimit të dispozitave ndëshkuese;
- Të rritet mbikëqyrja inspektuese në QHPz, në mënyrë që praktikët e realizimit të projekteve pa leje e pëlqime të mos përsëriten më;
- Komuna dhe MMPH e MKRS ta lexojnë drejt Raportin e Progresit 2014 dhe të veprojnë menjëherë;
- Komuna e Prizrenit të ndërpresë praktikën 'klandestine' të realizimit të projekteve në QHP

## VII. Për projektin

“Urbanism Watch” synon të instalojë një sistem të monitorimit permanent të aktivitetit shtetëror (në dy nivelet e qeverisjes) në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit urban në qytetin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të tij. Përmes të të gjeturave të monitorimit, ky sistem do të plotësohet me komponentët e publikimit dhe avokimit për të siguruar rend urbanistik në Prizren.

Qëllimi themelor i projektit është të pengojë degradimin e mëtejshëm urbanistik të Prizrenit dhe të ndikojë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm urban, përmes rritjes së transparencës dhe sigurimit të llogaridhënies në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

Projekti mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur.



## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore–SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë–Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t'i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

*Projektet kryesore:* Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014–2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch–Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013–2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013–2014), Qyteti gjithëpërfshirës–planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013–2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013–2014), Vullnetarët e Kulturës (2012–2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012–2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës(2012-2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011–2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011–2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008–2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

*Publikimet:* A ka dalje nga qorrsoaku urbanistik i Prizrenit?, Ku është Kalldrëmi i Prizrenit?, Harta e shtëpive të vjetra të Prizrenit, Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari-Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit–zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit–llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës”-film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi–analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Trasparenca”,.: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren(2012–2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).